



**NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË**  
**DISTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA**

Adresa: "Tirana", pn GJAKOVË, KOSOVË  
Tel & Fax: +381 (0) 390 328 329  
E: info@ngrohtorja.org

Nr. i Biznesit: 811326471  
www.ngrohtorja.org

Datë: 06.08.2021

## **NJOFTIM**

### **Licencimi i Aktivitetit të Prodhimit të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë në Kosovë**

Ndërmarrja N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë me adresë Rr "Tirana" P.N. përmes procedurës së Autorizimit për Ndërtim të Kapaciteteve të Reja, ka ndërtuar gjeneratorin elektrik nga biomasa me kapacitet **1.2 MW**, në lokacionin Rezina, komuna e Gjakovës, ANDAJ në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj **NJOFTON** palët e interesit se ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji për Licencim të aktivitetit të bashkëprodhimit të energjisë në Kosovë. Aplikacioni për licencim të aktivitetit të bashkëprodhimit të energjisë elektrike, me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjës të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimmarrje.

Pas licencimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji, i licencuari mund të kryej aktivitetin e bashkëprodhimit të energjisë në Kosovë, në pajtim me dispozitat e licencës, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh pune, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë. Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. "Dervish Rozhaja", Nr. 12, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: [hrexhaj@ero-ks.org](mailto:hrexhaj@ero-ks.org); Tel. 038247615/118.